



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 62, datë 30.11.2007

**“PËR MIRATIMIN E “BONUSI I TË PORSALINDURIT”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 11 pika 3/c, neni 12 pika 7, neni 32 gërma “dh”, në Ligjin Nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjëndjen civile” neni 56 dhe 64 gërma “e”, në Ligjin Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore”, në “Konventën e të Drejtave të Fëmijëve” dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.23, datë 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përkujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë në parim propozimin për pagesën “Bonusi i të porsalindurit” në shumën 5.000 lekë për çdo fëmijë të lindur e që rregjistrohet.
2. Efektet financiare të këtij projekti për vitin 2007, do të përballohen nga fondet e projekteve sociale miratuar me Buxhetin e vitit 2007.
3. Njësitë Bashkiake ngarkohen, që nëpërmjet Zyrave të Gjendjes Civile të verifikojnë dhe përcjellin dokumentin ligjor, pranë Bashkisë së Tiranës sipas udhëzimit përkatës.
4. Ngarkohet Bashkia e Tiranës të përgatisë udhëzimin për procedurat ligjore të dokumentacionit dhe mënyrën e pagesës, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria Juridike, si dhe Njësitë Bashkiake.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

**Sokol Dervishaj**

**K R Y E T A R**